

Analizë e titujve të
themeluara në bazë gjinore:

FEMICIDI

në mediat maqedonase

Analizë e titujve të
themeluara në bazë gjinore:

FEMICIDI

në mediat maqedonase

Publikues:

Instituti për studime komunikative
Rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për publikuesin:

prof. i çregull. D-r Zhaneta Trajkoska

Edicioni:

ResPublica

Autorë:

m-r Bojana Jovanovska
m-r Jovana Jovanovska

Redaktor:

m-r Dejan Andonov

Lektor:


Ruzhica Pejoviq

Dizajni grafik:

Igor Delov

Viti:

2023



Hyrje

Femicidi paraqet vrasjen e femrës sepse ajo është femër dhe paraqet manifestimin më ekstrem të dhunës mbi femrat, e cila shpesh herë është rezultat i eksponimit të kontinuar në dhunë, ku zakonisht dhunuesit janë partnerët intim, anëtarë të familjes ose persona tjerë të njohur për viktimën.¹ Femicidi mund të paraqitet si rezultat i llojeve të ndryshme të botëkuptimeve dhe praksave tradicionale, të cilat edhe sot janë të shpërndara nëpër gjithë botën. Ashtu për shembull, në disa shoqëri vazhdon koncepti që vrasje të caktuara të femrës të konsiderohen si të arsyetuara, siç është vrasja e femrës për shkak të tradhtisë ndaj partnerit.²

Në Maqedoni nuk egzistojnë të dhëna statistikore për numrin e femicideve, dhe kështu burime të vetme të të dhënave jozyrtare për femicidet në vend janë organizatat qytetare të cilat punojnë në këtë sferë dhe raportimet nga ana e mediave lidhur me këto raste. Të dhënat e vetme për femicidet janë të mbledhura nga ana e Rrjetit kombëtar kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës familjare “Zëri kundër dhunës”, e cila bëri një analizë të rasteve të femicideve në vend gjatë periudhës së fundit, përmes mbledhjes dhe krahasimit të të dhënave nga institucione të ndryshme, organizata të ndryshme dhe raportime mediatike.³

Me rëndësi të jashtëzakonshme është roli i medimeve dhe postimet e tyre në rastet e femicidit, por edhe mënyra se si paraqiten ato. **Mediumet në përgjithësi luajnë rol të rëndësishëm në luftën kundër dhunës në bazë gjinore** ku fuqia e medimeve është e gjërë dhe e shumëfishtë, duke nisur nga krijimi, formimi dhe ndryshimi i qendrimeve shoqërore, deri tek normalizimi kulturor dhe përforcimi i sjelljeve të caktuara, stereotipeve dhe paragjykimeve të caktuara. **Fuqia e medimeve shpesh herë nënvlerësohet**, posaçërisht në

1 Filip, A. (2017). *WAVE Thematic Paper. Preventing and Eradicating Femicide*. WAVE. Në dispozicion në: http://files.wave-network.org/researchreports/Thematic_Paper_Femicide_15Febr2017.pdf

2 Jovanovska B. (2022). *Vrasje të padukshme- Femicidet në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. HCPP.

3 Më tepër informata në www.glasprotivnasilstvo.org.mk

pjesën e dëmit që mund ta shkakton postimi i papërshtatshëm, mbi viktimat e dhunës me bazë gjinore (viktimizim sekondar) dhe femrave në përgjithësi, por edhe për rolin parandalues që mediumet duhet ta kenë në këtë sferë.

Mediumet duhet të jenë promovuesit kryesorë të barazisë gjinore dhe përmes lajmërimeve të tyre ti eliminojnë stereotipet gjinore, dhe përmes postimeve për dhunë në bazë gjinore të zhvillojnë rolin e tyre si aleat në luftën kundër këtij fenomeni. Postimet joadekuate, ku nuk respektohen standardet etike, shumë lehtë mund të kenë efekt të kundërt dhe kjo mund të kontribuon në diskriminim dhe jobarazi gjinore më të madhe në shoqëri.⁴

Me qëllim që të kryhet një analize rrënjësore mbi ndikimin e raportimeve mediatike për rastet e femicidit mbi përjetësimin e stereotipeve gjinore në shoqëri, Instituti për studime komunikative përpunoi analizën „Femicidi në mediumet maqedonase“, në korniza të proektit „Përdorimi i gazetarisë të themeluar në fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundërshtimit të dezinformatave në hapësirat mediatike në Maqedoninë e Veriut“, i cili realizohet me përkrahje të Ambasades të Britanisë në Shkup.

4 Avramovska Nushkova, A. и Tuneva, M. (2021). *Manual për raportim e ndjeshëm në aspekt gjinor*. HOPS – Opsione për jetë të shëndetshme Shkup.

Metodologjia

Përqëndrimi kryesor i kësaj analize **është** raportimi mediatik për femicidet, si formë më e rëndë e dhunës në bazë gjinore. Hulumtimi u krye me përdorimin e **analizës kualitative të raportimeve gazetareske për raste të femicideve, të postuara gjatë periudhës prej muajit shtator 2022 deri në muajin janar të vitit 2023**. Çështja kryesore e hulumtimit për të cilën analiza ka si qëllim të shpjegojë është se si raportimet mediatike për rastet e femicidit, si formë më e rëndë të dhunës me bazë gjinore, ndikon në përjetësimin e stereotipeve gjinore.

Analiza përmban **përpunim të dy studimeve të rastit** ku si bazë meret femicidi, dhe analizat e mëtejshme japin drejtim kah format e ndryshme të represionit institucional, gjegjësisht (jo)efikasitetit. Studimi i parë i rastit përfshin analizë të raportimeve mediatike për tre raste, nga të cilat dy janë vrasje ndërsa e treta tentim për vrasje të femrave sepse janë femra gjegjësisht femicide, në Maqedoninë e Veriut, ndërsa përmes studimit të dytë të rastit analizohet raportimi mediatik për protestën në Iran, si rezultat i vrasjes të Masha Amini. Rastet lokale të femicidit/tentimit për femicid janë si pasojë e joefikasitetit të institucioneve në veprimin e rasteve në dhunës në bazë gjinore, derisa në rastin e protestës në Iran femicidi vjen si pasojë e përdorimit efikas të ligjeve mizogjene nga ana e institucioneve.

Për qëllimet e kësaj analize u **analizua egzemplar nga 400 raportime gazetareske** për të dy studimet e rastit. U analizuan raportime gazetareske nga të gjitha online mediumet që raportuan për rastet që janë temë e kësaj analize, pa përzgjedhje plotësuese të medimeve të caktuara. Raportimet gazetareske u analizuan në aspekt të kryerjes të rolit për pengim të dhunës ligjërisht të përcaktuar të medimeve në luftën kundër dhunës në bazë gjinore, eliminimit të stereotipeve gjinore, ngritjes të vetëdijes publike për format e dhunës në bazë gjinore dhe pasojat që dhuna në bazë gjinore ka mbi femrat dhe

shoqërinë.⁵ Njëkohësisht, raportimet u analizuan nga aspekti i respektimit të parimeve për raportim etik sipas *Kodeksit të gazetarëve*⁶ si dhe *udhëzimet për raportim etik në online medime*⁷, lidhur me përcaktimin e burimeve të informacioneve, prezencë të senzacionalizmit gjatë informimit në raste të aksidenteve dhe tragjedive familjare, mosrespektimi i pprivatësisë të personit dhe plagjijatura. U analizuan këto aspekte:

- Cili është kapaciteti i medimeve që të njohin femicidin, si formë më e rëndë të dhunës në bazë gjinore, përkatësisht vrasje e femrës sepse është femër, ku duhet të egzistojë qëllim i nënkuptuar për kryerjen e vrasjes dhe lidhje e demonstruar mes veprës dhe gjinisë të viktimës?
- Sa e arrijnë mediumet nëpërmjet mbulimit mediatik të femicidit rolin (ligjor) parandalues përmes rritjes të ndërgjegjësimit në publikun të përgjithshëm për të gjitha format e dhunës në bazë gjinore, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore?
- Si vendos raportimi mediatik në korelacion represionin institucional dhe drejtat e femrave?
- Sa përfshin raportimi i mediave analizë të kontekstit shoqëroro-politik në të cilin zhvillohet veprimi në rastin konkret?
- Në çfarë mase mediumet përdorin gjuhë të ndjeshme ndaj gjinisë?
- Çfarë lloj i materijaleve vizuale përdoret në raportimet mediatike?
- Çfarë lloji të burimeve shfrytëzojnë për krijimin e përmbajtjeve në raportimet gazetareske?
- A ka dhe në çfarë mase respektohen standardet etike dhe të gazetarisë gjatë raportimit?
- A përdorin mediumet gjuhë senzionaliste gjatë krijimit të titujve për të tërhequr më shumë lexues, dhe të cilat janë josenzitive ndaj esencës të rastit dhe minimizojnë dhunën?
- Cili është ndikimi e raportimeve mediatike në krijimin e qëndrimeve të caktuara shoqërore për dhunën në bazë gjinore nga ana e publikut?
- Cili është ndikimi i mbingarkesës të qëndrimeve të shprehura në raportimin mediatik mbi vetëdijen publike?

5 *Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj femrave dhe dhunës familjare Gazeta zyrtare e RMV nr. 23.24/2021 viti 23.01.2021*

6 Kodeks i gazetarëve të Maqedonisë. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

7 <https://semm.mk/attachments/>

Kontekst i analizës

Me rëndësi të veçantë për këtë analizë është shqyrtimi i kornizës regulative relevante e cila i referohet raportimit mediatik, e cila përmban vetëregullim dhe dispozita ligjore regulative.

Te vetëregullimi në fokus me online gazetarinë, ajo që është me rëndësi të përmendet është se bëhet fjalë për përmbajtje e detyrueshme me rregullat e pranuar në përgjithësi, dhe jo për zgjedhje.⁸ Kodeksi i gazetarëve⁹ bashkë me *Udhëzime për raportim etik të online medimeve*¹⁰ përmbajnë udhëzime për raportim etik për çështje lidhur me të drejtat e njerëzve dhe dinjitetit të tyre. Sipas *Deklaratës për parime të sjelljes të gazetarëve të federacionit ndërkombëtar të gazetarëve*, gazetari duhet të jetë i vetëdijshëm për rrezikun nga diskriminimi që mund të mbështetet nga mediumet dhe duhet bërë çmos që ti evitohemi këtij lloji diskriminimi, mes tjerash në bazë të racës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, religjionit, bindjeve politike dhe prejardhja kombëtare ose sociale.¹¹

Në pjesën e legjislacionit, me rëndësi është **Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës familjare (Konventa e Stambollit)**¹², e cila në një pjesë të veçantë flet për rolin e medimeve në aspekt të eliminimit të stereotipeve gjinore. Detyrimet e përgjithshme që dalin nga Konventa janë në aspekt të marjes të masave për promovimin e ndryshimeve në shablonet shoqërore dhe kulturore të sjelljes të femrave dhe meshkujve, me qëllimin e eliminimit të paragjykimeve, adeteve, traditave dhe të gjitha praksave tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të femrave ose roleve stereotipe për femrat dhe meshkujt, ndërsa rekomandimet

8 Sarikakis K.. (2021). *Manual i Agjencionit për shërbime mediatike audio audiovizuale për monitorim të zbatimit të standardeve për raportim të rasteve të dhunës në bazë gjinore në medime*. Këshilli i Europës.

9 Kodeksi i gazetarëve në Maqedoni. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

10 <https://semm.mk/attachments/>

11 Deklarata për parime të sjelljes të gazetarëve. Në dispozicion në: <https://semm.mk>

12 *Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës mbi femrat dhe dhunës familjare*. Stamboll. , 11.V.2011

për mjetet e informimit publik janë në drejtim të stimulimit të pjesëmarrjes në përpunim dhe zbatim të politikave me respekt për lirinë e shprehjes dhe pavarësisë dhe përcaktimin e udhëzimeve dhe standardeve vetëregulatore për parandalimin e dhunës mbi femrat dhe për ritjen e respektit dhe dinjitetit të tyre.

Ligji për shërbimet audio dhe audiovizuale¹³ definon parime të cilat radiodifuzerët gjatë veprimtarisë së tyre duhet ti respektojnë, të cilat përfshijnë zhvillim të vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtje të privatësisë dhe dinjitetit të personit, barabarësi e lirive dhe e të drejtave pamvarësisht nga gjinia, raca, prejardhja kombëtare, etnike dhe sociale, bindja politike ose fetare, pozicionit pronësor ose shoqëror i njeriut dhe qytetarit, mbrojtje e identitetit të viktimave të dhunës, paraqitje objektive e ngjarjeve me tretman të njëjtë mbi pikpamjet dhe mendimet e ndryshme dhe mundësim i formimit të mendimit të lirë të publikut për raste dhe çështje të veçanta.

Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj femrave dhe dhunës familjare¹⁴ në disa nene i referohet rolit të medimeve në luftën kundër dhunës në bazë gjinore dhe i jep rëndësi të veçantë rolit parandalues të medimeve përmes promovimit të barazisë gjinore, eliminimit të stereotipeve gjinore, ngritjes të vetëdijes publike për format e dhunës në bazë gjinore dhe pasojat serioze të cilat i shkakton dhuna në bazë gjinore mbi gratë dhe shoqërinë.

Numër i madh i manualëve dhe hulumtimeve tregojnë se sa është me rëndësi të raportohet për dhunën në bazë gjinore dhe se çdo zë është i rëndësishëm në qoftë se kontribuon që ky fenomen të njihet, denoncohet, parandalohet ose në raste ideale të largohet tërësisht. Por, raportimi shkon bashkë me gjuhën që përdoret, titullin, fotografitë, terminologjinë, kontekstin i cili i jepet, burimet që shfrytëzohen dhe numrat të cilat paraqiten. Në vitin 2019 Organizata për arsim, shkencë dhe kulturë e Kombeve të bashkuara (UNESCO) pregaditi Manual për gazetarë Raportim për dhunë ndaj grave dhe

13 Ligji për shërbime mediatike audio audiovizuale.. Gazeta zyrtare e RM nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 u 27/19 dhe Gazeta zyrtare e RMV nr. . 42/20 u 77/21

14 Ligji i parandalimit dhe i mbrojtjes nga dhuna ndaj femrave dhe dhunës familjare Gazeta zyrtare e RMV nr.24/2021 nga viti 23.01.2021

vajzave¹⁵, i cili përmban udhëzime për raportim etik të medimeve dhe analizon ndikimet të cilat mund ti ketë raportimi mbi shoqëri, me fokus në femrat si viktima më të shpeshta të dhunës e këtij lloji.

15 Impe, A. (2019). *Reporting on Violence against Women and Girls. A Handbook for Journalists*. UNESCO. Në dispozicion në: <https://unesdoc.unesco.org/in/document>



Studim rasti: **Femicide në Maqedoninë e Veriut**

Në korniza të këtij studimi analizohet **raportimi mediatik lidhur me tre raste të veçanta, nga të cilat dy janë raste të femicideve dhe një është rast i tentimit për femicid, të cilat kanë ndodhur në janar të vitit 2023 në Shkup, Strumicë dhe Veles**. Në rastin e parë bëhet fjalë për vrasje të dy grave në moshë prej rreth 60 dhe 80 vjeçare, të cilat janë të vrara në datë 10.1.2023 në shtëpinë në të cilën kanë jetuar në rrugën Ruzveltova më Shkup. Vrasja është kryer nga ana e djalit të tyre, gjegjësisht nipit. Rasti i dytë i analizuar është në datën 20.1.2023 në Strumicë, ku bëhet fjalë për vrasjen e një gruaje 83 vjeçare nga ana e nipit të saj në shtëpinë e saj. Rasti i fundit është tentimi për vrasjen e vajzës 23 vjeçare nga ana e partnerit të saj, në datë 26.1.2023 në Veles, ku kryerësi i veprës ka kryer vetëvrasje pas tentimit për arrestim nga ana e policisë.

Shpesh herë, raportimet e para mediatike lidhur me vrasjet **nuk përmbajnë numër të madh të të dhënave** dhe i referohen të dhënave jozyrtare ose raportimeve primare të forcave policore. Mirëpo, edhe raportimi i mëtutjeshëm lidhur me vrasjet shpesh përbëhet nga tekste të shkurta ndërsa burimet e përdorura janë të kufizuara në lajmërimet nga institucionet

relevante, siç është Ministria për punë të brendshme (MPB) ose/dhe Prokuroria publike themelore. Raportimet janë gjenerike, faktografike dhe ngjasojnë ose janë identike njëra me tjetrën dhe shpesh transmetohen me tituj të njejtë ose pak të ndryshuara, dhe kanë përmbajtje dhe rend të raportimit thuajse identik.

Burime plotësuese në raportimet mediatike shfrytëzohen rallë herë, ndërsa statistika relevante dhe deklaratat janë të përdodura vetëm në dy raportime origjinale për rastin e femicidit në Shkup dhe në një raportim për rastin në Veles. Kështu, një nga raportimet gazetareske për rastin në Shkup me titull „66 femra të vrara për 10 vite në Maqedoni – dy prej tyre kanë qenë fëmij prej 5 deri 14 vjeç“¹⁶, duke u ndërlidhur me rastin, jep analizë të rasteve të vrasjeve të femrave përmes të dhënave nga Enti shtetëror për statistikë, mirëpo duke mos e marrë parasysh faktin që nuk janë të gjitha vrasjet e femrave femicide, vrasje e femrës është femër. Raporti përfshin dhe deklaratë nga Këshilli nacional për barazi gjinore (KNBG) për mosparaqitje të dhunës, si dhe për nevojën nga ndryshimet ligjore në drejtim të kriminalizimit të femicidit. Në raportin e dytë gazetaresk me titull „Vrasja e dyfishtë e djeshme përsëri aktuelizoi **çeshtjen** për rastet gjithnjë e më të shpeshta të dhunës familjare të cilat mbarojnë në mënyre fatale, ku viktimat më së shumti janë femra“¹⁷, kemi deklaratë të ministres për punë dhe politikë sociale Jovana Trençevska me informata se, rastit nuk i ka paraprijë dhunë, domethëne nuk ka pasur denoncime papaprake në Qendrën komunale për punë sociale si dhe deklaratë nga **HCPP**. Teksti shoqërohet me video inçizim, ku përveç tekstit dhe deklaratave, emitohen dhe skena të shkurta ku tregohet dhunë mbi femrat. Për rastin në Veles, vetëm një medium, një ditë pas vrasjes së kryer, raporton me titull “ Rastet e dhunës familjare janë kthyer në përditshmëri- Në vitin 2008 vret vëllaun, mbrëmë gjuan me armë zjarri në gruan ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore, dhe më pas kryen vetëvrasje!“¹⁸, ku jepet analizë më e gjërë e dhunës familjare, por dhe e rasteve tjera të femicidit.

16 [66 femra të vrara për 10 vite në Maqedoni – Dy prej tyre kanë qenë fëmijë nga 5 deri 14 vjet \(4news.mk\)](http://4news.mk)

17 [Shkupjani pasi vret nënën dhe gjyshen, niset për të vrarë dhe xhaxhain- Kanal 5 \(kanal5.com.mk\)](http://kanal5.com.mk)

18 [rastet e dhunës familjare janë shëndruar në përditshmëri- Në vitin 2008 vret vëllaun, mbrëmë gjuajti me armë zjarri gruan që ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore, dhe pastaj vret vehten! | Veçer...1963 | Vecer MK](http://Vecer.mk)

Në raportimet gazetareske aspak nuk **njihet dimenzioni gjinor i vrasjeve**, dhe as që merret parasysh fenomenologjia e femicideve, posaçërisht për atë se numri më i madh i këtyre vrasjeve janë kryer nga ana e partnerit mashkull ose nga familjarë, në vebdanimin e viktimës. Si plotësim i kësaj, **konteksti shoqëroro-politik në të cilin kryhet vepra aspak nuk është lëndë e analizave dhe aspak nuk bëhet korelacion me aspektin institucional**. Në përjashtim të një rasti, ku institucioni paraqet vetëm burim i të dhënave statistikore për dhunën, analiza e raportimeve mediatike na tregon se ata aspak nuk e marrin parasysh rolin e institucioneve në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, që në vendin tonë është një nga faktorët kryesorë për eskalim të dhunës në femicid. Në raportimet mediatike të cilat emitojnë informata për hetimin nga ana e PTP për rastin e Shkupit, mund të themi se vërehet fakti që bëhet fjalë për *vrasje gjatë kryerjes të dhunës familjare, në shtëpinë në rrugën “Franklin Ruzvelt”, i dyshuari i ka privuar nga jeta nënën dhe gjyshen e vet, duke iu shkaktuar më shumë lëndime me thikë, mirëpo arsya për njohjen e formës të dhunës është e vetme për shkak të marjes direkte të deklaratës nga prokuroria themelore*. Mediumet nuk e përdorin termin *femicid*.

Gjuha e cila përdoret në raportimet mediatike është josenzitive në aspekt gjinor, në fakt e zvogëlon peshën e dhunës sepse nuk e njeh vdekjen e femrës si pasojë direkte e asaj që është identiteti gjinor. Edhe pse në raportimet mediatike në mënyrë direkte nuk promovohen stereotipe gjinore, sidoqoftë zëri i viktimës është pasiv, dhe kjo kontribuon për mbijetesën e stereotipit gjinor për pozitën inferiore të femrës në shoqëri.

Në raportimet për tre rastet mediumet e vendosin fokusin në atë element nga ngjarja në bazë të cilit mund të krijojnë **tituj senzacionalistik**, dhe kështu shumë shpesh përdorin fjalë si: dramë, tragjedi, horror, tmerr, krim, morbide, bizare, të cilat nuk e shprehin esencën e vetë rastit.

Rasti që ndodhi në Shkup tërheq më shumë vëmendje nga mediumet, duke e pas parasysh se janë publikuar thuhetse 100 raportime lidhur me rastin në periudhë prej dy ditësh. Ajo që vendoset në qendër të fokusit është vrasja e dyfishtë dhe fakti se kryerësi i veprës e ka kaluar natën në të njejtën banesë me gratë të vrara, dhe kështu titujt që mund ti shohim kanë tendencën të vendosin në pah këto dy elemente. Dhe kështu kemi tituj si, „**RAST BIZAR NË MES TË SHKUPIT – Jo vetëm që i ka vrrarë nënën dhe gjyshen, por edhe ka rënë**

në gjum afër kufomave në banesë¹⁹ dhe „Akt monstruoz në mes të Shkupit: Jo vetëm që ka vrrarë nënën dhe gjyshen, por ka rënë në gjum afër kufomave në banesë– Mëngjesin e ardhshëm ka deshtë të vrasë dhe xhaxhain e tij“.²⁰ Plus kësaj, një nga raportimet mediatike lidhur me rastin shpallet nga ПИРЕС 24 me titull „Vrasje e dyfishtë: Burri therrë nënën dhe gjyshen në banesë në Shkup“²¹, ku një pjesë e madhe e medimeve marin lajmin nga ky medium, ku përsëritet narativi se kryerësi i veprës i *therr* viktimat, gjë që paraqet shenjë jorespekti ndaj viktimave dhe është e papërshtatshme. Përsëritja e terminologjisë joadekuate në raportimet gazetareske është e dukshme dhe me shembullin e titullit „Horror në rrugën Ruzveltova: Burrë therrë nënën dhe gjyshen në banesë në Shkup“²², e cila kontribuon që pjesë e madhe e raportimeve të ardhshme të përdorin termin *horror* në titujt e tyre për rastin. Disa medime marrin dhe një informacion jozyrtar nga Локално.МК për gjendjen e kryerësit të veprës, sipas të cilit *vrasësi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë dhe vetë ka lajmëruar për vrasjen që ka kryer*²³, ndërsa Sitel shpall video inçizim nga lajmet²⁴, të cilën e emitojnë disa medime, në të cilën intervistohen fqinjët, ku tregojnë disa të dhëna të përgjithshme për kryerësin, të cilin dukshëm nuk e njohin personalisht.

Në rastin e Strumicës, i cili sipas numrit të madh të raportimeve mediatike tërheq më shumë vëmendje, në qendër është mosha e viktimës, e cila shpesh thërritet si *plakë* në raportime.²⁵ Thuajse 5 ditë pas vrasjes, vetëm dy medime transmetojnë lajmërimin nga ana e MPB që kryerësi i veprës ka qenë në lidhje familjare me viktimën, përkatësisht ka qenë nipi i saj. Në mënyre plotësuese, disa medime, afër tekstit, transmetojnë dhe video inçizimin për rastin, nga YouTube- kanali i televizionit 24 Вести²⁶, duke përdorur klikbeit- tituj për

19 [RAST BIZAR NË MES TË SHKUPIT- Jo vetëm që vret nënën dhe gjyshen, por edhe bie në gjum afër kufomave në banesë \(faktor.mk\)](#)

20 [Akt monstruoz në mes të Shkupit: Jo vetëm që vret nënën dhe gjyshen, por edhe bie në gjum afër kufomave në banesë – Mëngjesin e ardhshëm ka deshtë ta vrasë dhe xhaxhain - VoStip](#)

21 [Vrasje e dyfishtë: Një person therrë nënën dhe gjyshen në banesë në Shkup | Press24](#)

22 [Horror në rrugën Ruzveltova: Një person therrë nënën dhe gjyshen në banesë në Shkup - Република \(republika.mk\)](#)

23 [Vrasje e dyfishtë në rrugën Ruzveltova, një burrë vret nënën dhe gjyshen e vetë- Локално \(lokalno.mk\)](#)

24 [Vrasje e dyfishtë në qendër të Shkupit- dy gra të vrara | Сител Телевизија \(sitel.com.mk\)](#)

25 [Gruaja e asfiksuar në shtëpinë e vet- ДУМА.МК \(duma.mk\)](#)

26 [Gruaja 83 vjeçare nga Strumica e vrrarë, kërkohet kryerësi - YouTube](#)

mënyrën e kryerjes të vrasjes si „(Video) GRUAJA PLAKË NË STRUMICË ËSHTË VRARË – policia kërkon kryerësin, ja si ka kryer veprën!“.²⁷

Pas shpalljes të disa postimeve, në raportimet mediatike të mëtejshme për rastin e Velesit dominojnë tituj që plotësisht përqëndrohen në kryerësin, faktikisht në arrestimin e tij, vetëvrasjen, dhe se ai ka qenë i dënuar për vrasjen e vëllaut, si për shembull „GJENDET I VDEKUR BURI I CILI KËTË PARADITE GJUAJTI ME ARMË ZJARRI VAJZËN 25 VJEÇARE – para kësaj ka vrarë dhe vëllaun e vet, ja detajet!“²⁸ dhe DRAMË NË VELES- PASI QË RRETHOHET NGA FORCAT POLICORE: vetëvrahet njeriu i cili këtë paradite rrahu, dhe e gjuajti me armë zjarri në pjesën e barkut vajzën 25 vjeçare nga Velesi“²⁹. Një pjesë e madhe e raportimeve mediatike e transmetojnë deklaratën nga Sektori për punë të brendshme në Veles, ku mes të tjerash thuhet se gruaja ka qenë me lëndime trupore të cilat ia ka shkaktuar *partneri me të cilin kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore*, ku kjo terminologji joadekuate meret nga një pjesë e madhe e medimeve edhe në titujt e tyre. Një medium i shpall emrin dhe mbriemrin e të dyshuarit.³⁰ Dhe më vonë gjatë mbëmjes disa medime transmetojnë për gjendjen e viktimës.

Fotografite që përdoren në raportimet mediatike në pjesën më të madhe janë gjenerike dhe thuajse askund nuk përmendet burimi i fotografive. Pjesë e madhe e raportimeve janë të shoqëruara me fotografi të amblemeve dhe veturave policore, fotografi nga ndërtesa e Prokurorisë, si dhe armë dhe gjak, dhe më pak fotografite e dhunës, të cilat, përveç që janë shqetësuese, nuk transmetojnë të dhëna adekuate për rastin. Disa medime paraqesin fotografi nga i dyshuari i vrasjeve në Shkup që e marin nga shpallja FOTO I Vrasësi i dy grave nga rr. Ruzveltova, banesa e mbuluar me gjak“³¹, për të cilën nuk ka të dhëna nga ku është marë, e as a egziston pëlqim për shpalljen e saj.

27 [INFOMAX.MK](#)


28 [GJINDET I VDEKUR BURI I CILI PARADITE ME ARMË ZJARRI PLAGOSI VAJZËN 25 VJEÇARE – Para kësaj ka vrarë dhe vëllaun, ja detajet! \(centar.mk\)](#)

29 [DRAMË NË VELES – PASI QË RRETHOHET NGA FORCAT POLICORE – vetëvrahet personi i cili këtë paradite rrahu dhe gjuajti me armë zjarri në pjesën e barkut vajzën 25 vjeçare nga Velesi - MAKTEL \(maktel.mk\)](#)

30 [Personi nga Velesi i cili mengjesin e sotëm rrahu dhe gjuajti me armë zjarri në vajzën 25 vjeçare këtë mbasdite kreu vetëvrajse – nuk lejoi të arrestohet nga ana e policisë \(makedonskivesnik.com\)](#)

31 [FOTO I Vrasësi i dy grave nga rruga Ruzveltova, banesa e mbuluar me gjak - Вечер \(vecer.mk\)](#)

Thuajse të gjitha raportimet mediatike janë të shpërndara përmes kanaleve zyrtare të medimeve në rrjetet sociale. Pjesa më e madhe e komenteve në rrjetet sociale janë në drejtim të ngushëllimit për viktimat dhe dënim i fuqishëm i dhunës, i cili ndonjëherë kalon në kërcënime për sjellje dhunuese dhe/ose ofendime të drejtuara kah kryerësi i veprës i cili kualifikohet si monstër, i sëmurë, narkoman etj. Mirëpo, edhe pse shumë rallë, mund të shohim dhe komente që arsyetojnë dhunën, si për shembull, *mirë i ka duruar deri tani! Përshendetje deri te trimi!! Ose Kush është aq jonormal që për grua të shkojë në burg.*



Studim rasti: **Protesta në Iran**

Në këtë studim rasti u analizua **raportimi mediatik për femicidin e Mahsa Amini në Iran nga ana e policisë të moralit dhe protesta që u organizua dhe u mbajt për shkak të femicidit**. Në këtë rast bëhet fjalë për një grua 22 vjeçare, Mahsa Amini, e cila ka qenë e arrestuar nga ana e policisë të moralit në datë 13.9.2022, sepse nuk ka respektuar regullat për mbajtjen adekuate të hixhabit. Gjatë arrestimit të saj nga ana e policisë mbi të është ushtruar fuqi e madhe, e cila ka kaluar në brutalitet policor, nga e cila Amini ka fituar lëndime vdekjepruese. Këtë e kanë konfirmuar dëshmitarë të rastit, edhe pse policia më vonë tërësisht i demanton këto akuza dhe informon se Amini papritmas ka humbur vetëdije në stacionin policor dhe është transferuar në spital. Në të njejtën ditë Amini ka qenë e hospitalizuar në gjendje pa vetëdije dhe i është konstatuar vdekje e trurit dhe tre ditë më vonë, në datën 16.9.2022, ajo ndërrohet jetë. Vrasja e Amini shkakton reaksione shumë të zëshme dhe intenzive në Iran, ku të njejtën ditë fillojnë protesta, të cilat vazhdojnë dhe sot.

U analizuan 153 raportime gazetareske nga medime, të cilat në qendër kanë vrasjen dhe protestat për shkak të vrasjes e Iranases Mahsa Amini nga ana e *policisë të moralit*, si dhe reaksionet të cilat kjo vrasje i shkaktoi në Iran dhe në Botë. Si plotësim, u analizuan dhe lajme që referohen për zhvillimin e protestave dhe ngjarjet në dy muajt pas vrasjes, me qëllim që të paraqitet

ndikimi i protestave dhe në çfarë mënyre është raportuar për to. Lajmet u analizuan në aspekt kronologjik nga data fillestare kur paraqitet lajmi i parë për vrasjen. Për qëllimet e kësaj analize do të jepet një rezime më e detajuar e raportimeve të para të rastit, derisa raportimi i mëtejshëm do të analizohet në mënyre më të përgjithshme, duke i vërejtur dhe treguar praksat e mira dhe të këqija.

Njëlloj si në studimin e parë të rastit, edhe në këtë rast baza është femicidi, ku gjë e përbashkët është ajo që edhe në të dy rastet bëhet fjalë për represion institucional, me një dallim që në rastin e protestës në Iran femicidi vjen si pasojë e zbatimit *efikas* të ligjeve mizogjene nga ana e institucioneve.

Vrasja e Masha Amini ndodhi në 16.9.2022 dhe derisa lajmet në Botë menjëherë raportuan për këtë lajm, tek ne në ditën e vrasjes regjistrojmë vetëm një lajm me titull “Mllef në Iran pas vdekjes të gruas së re pas arestit nga policia e moralit”³². Në raportimin mediumi përdor terme si brutalitet policor, jep kontekst në ngjarjet dhe vrasjen, e cila vjen në kohë të represionit të madh mbi gratë në Iran, përcjell të dhëna të shpallura nga policia dhe nga dëshmitarë dhe nuk shfrytëzohen shpekulime. Përkundër kësaj, në raportimin mediatik përdoren fotografi nga spitali ku viktima është në jonetëdije, fotografi për të cilat nuk përmendet as burimi, e as pëlqimi eventual për shpalljen e tyre.

Ditën tjetër në 17.9.2022 kemi rritje të interesit për raportim dhe katër medime tjers raportojnë për ngjarjen. Ajo çka vihet në dukje nga raportimi fillestar për vrasjen dhe protestat me rastin e vrasjes të Amini, është se medimet në përgjithësi japin kontekst në ngjarjet dhe transmetojnë deklarata edhe nga policia edhe nga dëshmitarë dhe persona të afërm të viktimës. Por gjithashtu shihet se **numër i vogël i tyre përdorin terminologji adekuate dhe gjuhë adekuate në pajtueshmëri me standardet për raportim në raste të dhunës në bazë gjinore, thuajse të gjithë përdorin fotografi joadekuate, ku viktima është në jonetëdije dhe e shtrirë në spital, dhe asnjë nga medimet qartë nuk bën korelacion mes brutalitetit me pasojë- vdekje, gjegjësisht vrasje e femrës sepse është femër (femicid).**

32 [Mllef në Iran pas vdekjes të gruas së re pas arestit nga ana e policisë të moralit - Независен Весник \(nezavisen.mk\)](http://nezavisen.mk)

Shembull i mirë për përdorim të terminologjisë adekuate, përveç senzacionalizmit të titullit “POLICIA E RRAHU PËR VDEKJE PËR IMORALITET, RIEDUKIM I PËRGJAKSHËM: Gruaja e re Iraniane ndërron jetë nga brutaliteti policor”³³, ku përdoren termet si: brutaliteti policor, femicid, vrasje dhe shkaktim i vdekjes si pasojë e brutalitetit policor, por përsëri përdoren fotografi joadekuate të viktimës.

Në raportimin e gazetarëve me titull “Iranasja e re ka qenë e “riedukuar” deri në vdekje sepse në mënyre të gabuar ka mbajtur hixhab (VIDEO)”³⁴, edhe pse në titullin përmendet se Amini në mënyre të gabuar ka mbajtur hixhabin, në raportin më tej thuhet se ajo nuk ka mbajtur hixhab edhe për atë arsye ka qenë e arestuar. Më nuk përmendet brutaliteti ose vrasja, edhe pse qartë titulli i referohet asaj. Konteksti vihet në ligjet represive dhe transmetohen reagime nga trupat ndërkombëtare.

Në raportin mediatik me titull „Protestë dhe dënim ndërkombëtar pas vdekjes të Iranases 22 vjeçare e cila ndërron jetë pasi që arestohet nga policia e moralit”³⁵ nuk përmendet vrasja si pasojë e brutalitetit policor, por përdoren terme si *vdekje e dyshimtë* dhe *rrahje*. Kontekst i jepet vetëm shkurtë dhe transmetohen reagime dhe kërkesa për përgjegjësi.

Ditën tjetër në datë 18.9.2022 regjistrohen 12 raportime për vdekjen e Amini dhe protestat në Iran. Pjesa më e madhe e raportimeve në fokus kanë protestat dhe mllefin e grave dhe gjithë Iranit për shkak të vdekjes të Aminit. Më të zakonshme janë titujt si „Vdekja e Iranases së re ngriti vendin në këmbë: Gratë e mllefosura filluan ti djegin hixhabet dhe ti prejnë flokët”³⁶, „Iranaset e larguan hixhabin si shenjë proteste për shkak të vdekjes të vajzës në paraburgim: Ka qenë e rrahur nga policia e moralit”³⁷ dhe „Protesta në Iran,

33 faktor.mk

34 [Iranasja e re e “riedukuar” deri në vdekje, sepse në mënyre të gabuar ka mbajtur hixhab\(ВИДЕО\) - Вечер \(vecer.mk\)](http://Iranasja%20e%20re%20e%20%22riedukuar%22%20deri%20n%C3%AB%20vdekje,%20sepse%20n%C3%AB%20m%C3%ABnyre%20t%C3%AB%20gabuar%20ka%20mbajtur%20hixhab%28VIDEO%29-%20Вечер%20%28vecer.mk%29)

35 [Protestë dhe dënim ndërkombëtar pas vdekjes të Iranases 22 vjeçare e cila ndërron jetë pasi që arestohet nga policia e moralit \(slobodnaevropa.mk\)](http://Protest%C3%AB%20dhe%20d%C3%ABnim%20nd%C3%ABrkomb%C3%ABtar%20pas%20vdekjes%20t%C3%AB%20Iranases%2022%20vje%C3%ABare%20e%20cila%20nd%C3%ABrron%20jet%C3%AB%20pasi%20q%C3%AB%20arestohet%20nga%20policia%20e%20moralit%20%28slobodnaevropa.mk%29)

36 [Vdekja e Iranases të re ngriti vendin në këmbë: Gratë të mllefosura filluan ti djegin hixhabet dhe ti prejnë flokët - Слободен печат \(slobodenpecat.mk\)](http://Vdekja%20e%20Iranases%20t%C3%AB%20re%20ngriti%20vendin%20n%C3%AB%20k%C3%ABmb%C3%AB:%20Grat%C3%AB%20t%C3%AB%20mllefosura%20filluan%20ti%20djegin%20hixhabet%20dhe%20ti%20prejn%C3%AB%20flok%C3%ABt%20-%20Слободен%20печат%20%28slobodenpecat.mk%29)

37 [Iranaset e larguan hixhabin si shenjë protesti për shkak të vdekjes të vajzës në paraburgim: Ka qenë e rrahur nga policia e moralit/VIDEO| Вечер ...1963 | Vecer MK](http://Iranaset%20e%20larguan%20hixhabin%20si%20shenj%C3%AB%20protesti%20p%C3%ABr%20shkak%20t%C3%AB%20vdekjes%20t%C3%AB%20vajz%C3%ABs%20n%C3%AB%20paraburgim:%20Ka%20qen%C3%AB%20e%20rrahur%20nga%20policia%20e%20moralit/VIDEO|Вечер...1963|VecerMK)

pasi “policia e moralit’ rrahu deri në vdekje vajzën shkaku hixhabit”³⁸. Në portalet që më kishin transmetuar lajmin ditë më parë shihet lidhshmëri e mirë gjatë raportimeve, duke u kujdesur në rrjedhshmërinë, duke dhënë kontekst plotësues dhe zhvillim të ngjarjeve, por dhe vazhdueshmëri e praksës jo të mirë ku përdoret terminologji dhe gjuhë dhe fotografi mbështetëse të papërshtatshme. Pjesë e madhe e titujve, por edhe vetë raportimet mediatike, i referohen asaj se vdekja e Iranases është si pasojë e mbajtjes të gabuar të hixhabit, duke hedhur fajin mbi *pandëgjueshmërinë* e gruas dhe vdekja si pasojë e kësaj pandëgjueshmërie („Vdekja e Iranases të re shkaku mbajtjes të gabuar të hixhabit ngriti në këmbë gratë – Të mllefosura filluan ti djegin hixhabet dhe ti prejnë flokët”³⁹). Pjesë e vogël e portaleve në mënyre direkte bëjnë korelacion mes vdekjes me brutalitetin e policisë si rezultat i ligjeve mizogjene Iraniane dhe përdorin gjuhë si *ra në komë dhe ndërron jetë pas arrestimit*⁴⁰. Në një pjesë të raportimeve mediatike nuk jepet asnjë kontekst plotësues dhe në mënyrë të thatë transmetohen të dhëna pa burime plotësuese.⁴¹

Në ditët e ardhshme rritet numri i lajmeve për këtë rast si rezultat i reagimeve nga ana e Organizatës së Kombeve të bashkuara, Unionit europjan, Amnesty International dhe rastet e para të vrasjeve gjatë zgjatjes të protestave. Ajo që është e dukshme në raport është se në asnjë raportim mediatik nuk përdoren termine si dhunë në bazë gjinore, dhunë gjinore, femicid, vrasje shkaku gjinisë, thyerje e drejtave njerëzore, dhe zakonisht nuk jepet kontekst më i gjërë për thyrjen e drejtave të grave në Iran dhe për atë se me çfarë represion ballafaqohen gratë në atë vend. Përveç kësaj, në asnjë raport lajmesh nuk egziston asnjë hulumtim plotësues dhe pamje të statistikave për raste tjera të arrestimit, dhunës, brutalitetit policor dhe vrasjeve të grave në Iran nga ana e *policisë të moralit*, të cilat themelohen në ligjet represive mizogjene Iraniane. Në një nga raportimet përmendet se *shumë Iranian, posaçërisht të rinjtë, e kuptuan vdekjen e 22 vjeçares si pjesë e represionit të Republikës islamike kundër*

38 [Protetë në Iran, pasi “policia e moralit” rrahu deri në vdekje vajzën shkaku hixhabit \(ВИДЕО\) - Канал 5 \(kanal5.com.mk\)](#)

39 [Vdekja e Iranases së re ngriti vendin në këmbë: Gratë të mllefosura filluan ti djegin hixhabet dhe ti prejnë flokët - Слободен печат \(slobodenpecat.mk\)](#)“ Vdekja e Iranases së re shkaku mbajtjes të gabuar të hixhabit ngriti në këmbë gratë – Të mllefosura filluan ti djegin hixhabet dhe ti prejnë flokët- Вечер (vecер.mk)

40 [Protesta të dhunshme në Iran pas vdekjes të vajzës e arrestuar shkaku mbajtjes të gabuar të hixhabit – Ka të vdekur? - Вечер \(vecер.mk\)](#)

41 [Në Iran ndërron jetë vajza pasi i rrah nga ana e policisë të moralit \(tv21.tv\)](#)

mosmarëveshjeve dhe sjelljes e policisë të moralit gjithnjë më agresive kah femrat e reja.⁴² Gjuha që përdoret ulë peshën e vetë rastit dhe represionit me të cilin ballafaqohen femrat në Iran në përditshmërinë e tyre, sepse vdekja e Aminit paraqet pasojë direkte e brutalitetit policor dhe represionit mbi femrat, e cila nuk mundet të interpretohet ose të *kuptohet* ndryshe.

Nga analiza e raportimeve në rrjetet sociale në mënyre evidente mundet të shihet se numri më i madh i postimeve nuk kishin komente ose kishin disa komente në aspekt të empatisë me viktimën dhe dënim të brutalitetit policor. Kjo nënkupton se ose lajmi nuk ka hasur në interes për të komentuar nga ana e publikut ose ajo që komentet e papërshtatshme janë fshirë nga ana e vetë mediumit.

Raportimi në ditët në vijim i referohet rritjes së numrit të vdekurve në kohën e protestës , ku numri rritet mbi 30 persona, edhe atë një javë pas fillimit të protestës. Çfarë mund të vërehet në njoftimet e mëvonshme është ndryshimi i gjuhës të medimeve, ku tani më zakonisht përdorin termine si vrasje dhe bëjnë korelacion me verpimet e policisë, përkatësisht me brutalitetin e saj. Në një nga raportimet gazetareske përmendet që *arsye për trazirat në Iran është vdekja e Aminit, e vrarë nga ana e policisë shkaku se ka mbajtur gabimisht hixhabin*⁴³. Fotografite që përdoren thuajse në të gjitha raportimet janë ato nga protestet, dhe rallë herë fotografi të Aminit. Ajo që mund të vërehet është se në këtë stadium, raportimi është i bazuar në të dhëna faktografike dhe raportimet gazetareske ngjasojnë njëra me tjetrën. Vetëm se në raportimet e reja për vrasje të grave gjatë protestës mund të vërehet përmirsim në gjuhën dhe terminologjinë me përdorim të fjalëve *vrasje e gruas* dhe *policia e vrau në mënyre brutale*⁴⁴.

Për dallim nga mediumet maqedonase, mediumet në Europë më shumë vëmendje i dedikuan kontekstit në të cilin u krye vrasja e Aminit. Fokusi ishte në luftën për autonominë mbi trupin dhe lirisë për zgjedhje mbi jetën tënde. Raportimi në esencë kishte thyerjen e të drejtave njerëzore përmes dhunës gjinore dhe femicidit si pasojë. Largë nga premtimi i revolucionit

42 [Protista në Iran: Gratë djegin hixhabet për shkak të vrasjes të vajzës të re\(ВИДЕО\) - Канал 5 \(kanal5.com.mk\)](https://www.kanal5.com.mk)

43 [Numri i viktimave në trazirat në Iran u rrit në 31 persona - Независен Весник \(nezavisen.mk\)](https://www.nezavisen.mk)

44 [\(ВИДЕО\) Edhe një vrasje femrës në Iran.Pa hixhab u nis kah policia e cila e gjuajti me 6 plumb \(a1on.mk\)](https://www.a1on.mk)

për liri dhe drejtësi sociale, mediumet e pershkruanin regjimin iranian si imponim i regulativave represioniste mbi trupat femërore.⁴⁵ Në mediumet tona rallë hasim terme si *revolucion femëror*⁴⁶ dhe më shumë përdoret termi protest pa ndonjë kuptim më të gjërë. Në një raportim gazetaresk i një mediumi vërehet interes më i madh për kuptimin më të gjërë dhe ka rrjedhshmëri në raportimet gjatë muajve, me kritikizëm ndaj thyerjes të drejtave njerëzore. Në një nga raportimet gazetareske në këtë medium thuhet se *edhe në shekullin 21 vazhdon të jetë prezent trendi i kufizimit i të drejtave të femrave në gjithë botën. Fatkeqësisht në shtete të caktuara femrat vazhdojnë të janë qytetarë të rendit të dytë, ata janë të mbyllura dhe të vrara vetëm për shkak të qëndrimeve të shpalosura dhe veshje “të papërshtatshme”. Viti i cili kaloi u shënuar nga solidariteti mes dhe me femrat e Iranit, ndërsa vajza 22 vjeçare kurdistane, Masha Amini u shëndrua në simbol i pamposhtmërisë*⁴⁷.

45 Më tepër informata: <https://www.media-diversity.org>

46 VIDEO: „Revolucioni femëror” në Iran u shëndrua në masakër- 8 persona të vrarë- Слободен печат (slobodenpecat.mk)

47 Gra, jetë, liri- a dot munden Iranaset të fitojnë teokracinë - Слободен печат (slobodenpecat.mk)

Diskusioni përfundimtar

Duke u nisur nga premisa se femicidi paraqet vrasje e femrës sepse është femër, ku patjetër të egzistojë qëllim i implikuar për kryerjen e vrasjes dhe lidhshmëri të demonstruar mes veprës dhe gjinisë të viktimës, analiza e rasteve tregon **në kapacitetin relativisht të ulët të medimeve ta njohin femicidin**, si formë më e rëndë e dhunës në bazë gjinore. Femicidi si i tillë është thuajse i panjohur nga ana e medimeve në raportimet për protestet në Iran, ku qartë shihet se nuk egziston asnjë lidhje direkte mes dhunës dhe brutalitetit me pasojë- vdekje. As në Maqedoninë e Veriut nuk njihet komponenta gjinore në vrasjet e grave , as nuk merret parasysh fenomenologjia e femicideve, posaçërisht që pjesa më e madhe e këtyre vrasjeve janë kryer nga ana e partnerit ose familjarë meshkuj, në vendbanimin e viktimës.

Egziston një mungesë e rëndësishme e inkuadrimit të kontekstit shoqëroro-politik në analizë në të cilin zhvillohet veprimi në rastet, që është i dukshëm në raportimet gazetareske për rastet e femicidit në Maqedoninë e Veriut . Në raportimet gazetareske për protestet në Iran pjesërisht i dedikohet vëmendje kontekstit në të cilin ndodhin vrasja dhe protestat dhe vetëm një pjesë e vogël e medimeve i kushtojnë vëmendje kontekstit më të gjërë dhe në mënyrë të rjedhshme raportojnë për atë se si protestat reflektojnë mbi jetën e femrave dhe çfarë domethënie ka ky “revolucion” për femrat në Iran.

Si plotësim, lidhur me korelacionin e tyre me aspektin institucional, analiza e raportimeve mediatike për rastet lokale tregon në faktin se ato absolutisht nuk **marin parasysh rolin e institucioneve në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, posaçërisht nga femicidi**, përveç në një rast, ku institucioni paraqet vetëm burim i të dhënave statistikore për dhunën. Në rastin e protestës në Iran, represionin institucional mbi gratë mediumet e paraqesin përmes raportimit për “policinë të moralit” si mjet për represion, ndërsa ligji dhe qeveria që i ka sjellë, si burim i represionit. **Raportimi zakonisht ka karakter informativ** lidhur me formimin dhe funksionimin e policisë dhe, edhe pse një pjesë e madhe e raportimeve gazetareske bëjnë korelacion mes ligjit dhe

policisë si burim i represionit dhe thyrjes të drejtave njerëzore të femrave si subjekt i këtij represioni, sidoqoftë lidhja është superficiale dhe nuk i nënshtrohet kritikave. Praksa represive është a pandryshueshme sepse *thjeshtë ligji atje është i tillë*.

Nga analiza e rasteve mund të sjellim konkludim se **gazetaria analitike dhe e thellë thuajse nuk egziston, pa marë parasysh a bëhet fjalë për raportim për raste nacionale ose të huaja**. Pjesë e madhe e raportimeve janë gjenerike, faktografike dhe shumë ngjasojnë njëra me tjetrën ose janë identike. Lajmet transmetohen shpesh dhe janë me tituj të njejtë ose shumë pak të ndryshuar, dhe përmbajtje thuajse identike dhe radhitje identike të raportimit. Raportimet për rastet lokale shpesh janë të shkurtuara dhe burimet që shfrytëzohen janë të kufizuara në lajmërimet e institucioneve përkatëse. Burime plotësuese përdoren shumë rallë, ndërsa statistikë relevante dhe deklarata janë të përdodura vetëm në dy raportime origjinale për rastin e femicidit në Shkup dhe në një raportim për rastin në Veles.

Në raportimet mediatike **thuajse nuk përdoret gjuha senzitive në gjini**. Edhe pse raportimet në mënyre direkte nuk promovojnë stereotipe gjinore, sidoqoftë zëri i viktimës është në plan të dytë, që aktualisht **përjetëson stereotipin gjinor për inferioritetin e femrës në shoqëri**. Numër më i madh i medimeve përdorin gjuhë senzacionaliste gjatë krijimit të titujve për të tërhequr më shumë lexues, shumë shpesh me përdorimin e klikbeit titujve që përmbajnë fjalë si: dramë, tragjedi, horror, tmerr, krim, morbide, bizare, të cilat janë josenzitive ndaj esencës të rastit. Në rastin e protestës në Iran një pjesë e titujve, edhe pse senzacionaliste, njëkohësisht minimizuan dhunën, në fakt mund të vërehet minimizim i dhunës më shumë si rezultat i terminologjisë joadekuate.

Përdorimi i materialeve vizuale në kornizat e raportimeve mediatike është i papërshtashëm nga disa aspekte. Posaqërisht është problematik fakti që thuajse askund nuk përmendet burimi i fotografive. Kështu, përdoren fotografi nga Amini ku viktima është në jovetëdihe dhe është evidente se për ato fotografi ajo nuk ka dhënë pëlqim, çka tregon në faktin se ka publikim të pautorizuar. Zakonisht përdoren fotografi me ambleme të policisë, si dhe armë zjarri dhe gjak, të cilat përveç që mund të jenë shqetësuese, nuk transmetojnë të dhëna adekuate për ngjarjen.

Në aspekt të respektimit të standardeve etike dhe gazetare gjatë raportimeve, **analiza tregon thyerje të disa parimeve nga kodeksi i gazetarëve të Maqedonisë** duke mos e përmendur burimin e të dhënave, plagjijaturë, mosrespektimi i privatësisë të personit, si dhe prezenca e senzacionalizmit gjatë informimit në ngjarje të fatkeqsive dhe tragjedive familjare.⁴⁸

Sipas analizës të raportimeve në rrjetet sociale dhe komentet në postimet lidhur me ngjarjet, pjesë e madhe janë në drejtim të empatisë me viktimën ose dënim për vrasjen dhe kryesin, e cila ndonjëherë kalon në kërcënime për sjellje dhunuese ose/ dhe fyerje të drejtuara kah kryerësi. Edhe pse rallë, kemi dhe komente ku arsyetohet dhuna dhe nënshtrimi tradicional i gruas në shtëpi, ku ajo ka shkaktuar dhunën. Numri i vogël i komenteve në raportimet për rastin në Iran tregon në faktin se lajmi ose nuk ka hasur në interes për të komentuar nga ana e publikut ose ajo që komentet të papërshtatshme janë fshirë nga ana e medimeve.

Kur bëhet fjalë për rolin parandalues për ngritjen e vetëdijes në publikun të përgjithshëm për të gjitha format e dhunës në bazë gjinore, si dhe promovimit të barazisë gjinore dhe eliminimit të stereotipeve për rolet gjinore, e cila është dhe e përcaktuar me ligj, analiza e **mbulimit mediatic të femicideve tregon se ka nivel alarmues të ulët** se ku gjinden mediumet gjatë realizimit të këtij roli.

Duke pas parasysh të gjitha konkluzionet e dhëna, mund të konstatojmë se **mediumet nuk kanë ndikim të rëndësishëm në krijimin e qëndrimeve të caktuara shoqërore për dhunën bazë gjinore**, përkatësisht nuk ndikojnë në mënyre pozitive në krijimin e mendimit shoqëror në drejtim të njohjes me fenomenologjinë e dhunës në bazë gjinore dhe femicidit si formë më e rëndë e saj, karakteristikat e saja dhe pasojat negative mbi femrat. Në këtë mënyrë mediumet e anashkalojnë rolin parandalues që kanë dhe lejojnë mbijetesën e stereotipeve gjinore lidhur me dhunën.

48 Kodeksi i gazetarëve në Maqedoni. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

Pikëpamje përfundimtare

Duke pas parasysh analizën e raporteve gazetareske dhe argumentet e përmendura në diskutimin përfundimtar, kemi këto perceptime kyçe lidhur me raportimet mediatike për rastet e femicidit si formë më e rëndë e dhunës në bazë gjinore:

- Mediumet nuk kanë ndikim të konsiderueshëm mbi krijimin e qëndrimeve të caktuara shoqërore për dhunën në bazë gjinore;
- Mediumet kanë kapacitet relativisht të ulët për ta njohur femicidin;
- Egziston mungesë reale nga inkuadrimi i analizës i kontekstit shoqëroro-politik;
- Mediumet nuk marrin parasysh rolin e institucioneve në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në bazë gjinore, posaçërisht femicidit;
- Mediumet nuk përdorin gjuhë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe e përjetësojnë stereotipin gjinor për inferioritetin e gruas në shoqëri;
- Pjesa më e madhe e medimeve përdorin gjuhë senzacionaliste, posaçërisht në titujt e raportimeve mediatike;
- Përdorimi i materialeve vizuale në korniza të raportimeve mediatike është joadekuate;
- Në raportimet gazetareske thehen disa parime të Kodeksit të gazetarëve në Maqedoni;
- Gazetaria analitike thuhet se nuk egziston, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për raportim për raste nacionale ose të huaja;
- Raportimi mediatik për femicidin tregon në nivel të ulët të kryerjes të rolit parandalues për ngritjen e vetëdijes në publikun e përgjithshëm.



British Embassy
Skopje



Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit “Përdorim i gazetarisë të themeluar ne fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundërshtimit të dezinformacioneve në hapësirat mediatike në Maqedoninë e Veriut “ i finansuar nga Qeveria e Mbretërisë së bashkuar me përkrahje e Ambasadës britaneze në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të paraqitura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.



Институт за
комуникациски
студии

